

RELACION TEKNIK

PER OBJEKTIN: RIKONSTRUKSION I SHKOLLES 9 – VJEÇARE

FSHATI MUSTAFE

NJESIA ADMINISTRATIVE ARRAS

BASHKIA DIBER

Bazuar në buxhetin e vitit 2022 të Bashkisë Dibër, për investimin në objektin: **RIKONSTRUKSION I SHKOLLES 9 – VJEÇARE, FSHATI MUSTAFE**, prej 3 965 645 lek të reja, me tvsh, dhe 3 304 704 lek pa tvsh, nga ana jonë, nisur edhe nga kërkesat e vazhdushme të Zyrës Arsimore Dibër, banorëve të fshatit Mustafe, si dhe Njesisë Administrative Arras, lidhur me problematikën emërgjente të rehabilitimit të objektit në fjalë, nga ana jonë u hartua preventivi, duke përcakuar zërat më të domosdoshëm për rikonstruksionon e objektit të mësipërm.

Shkolla 9 - vjeçare e fshatit Mustafe, është ndërtuar në vitin 1985, pra ka një vjetërsi pothuajse 40 vjeçare.

Nga kontrolli dhe verifikimi i bërë në vend nga ana jonë, rezulton se ajo është pothuajse e amortizuar .

Çatia e sajë me një sipërfaqe prej 520 m², është gati 50% e dëmtuar, ku në shumë vende ka pësuar ulje, duke u dëmtuar lenda mbajtëse e drurit.

Në shumë vende pikon dhe ka të dëmtuara tjegullat dhe kulmarët.

Theksojmë se në këte shkollë që nga koha e ndërtimit janë bërë ndërhyrje shumë të vogla. duke bërë disa riparime kalimtare.

Gjithashtu përjashtuar dy klasa që janë dyshemetë e shtruara me pllaka importi kohët e fundit, së bashku me nyjet sanitare, të gjitha ambjentet janë me pllaka çimentoje të shtruara në momentin që është ndërtuar shkolla në vitin 1985, dhe janë me gropa dhe të dëmtuara pothuajse komplet.

Theksojme se janë të dëmtuara dhe nuk ekziston fare shkarkimi vertikal i ujrave të shiut dhe bores nga çatia, duke bërë që ujrart në ditët me shi, nga era, të derdhën në sipërfaqen e mureve duke dëmtuar suvatimet e jashtëme dhe të brendshme.

Edhe në pjesën e brendshme të shkollës ka lagështi, e cila ka rënë nga çatia e dëmtuar, si dhe në ambjentet e katit të parë sidomos pjesa nga mbrapa, janë të demtuara shumë suvatimi i jashtëm tek xoklatura dhe suvatimi i brendshëm , pasi ujrart e shirave dhe të dimrit që vinë nga pjesa e sipërme e terrenit, shkarkohen në murin e mbrapëm të shkollës.

Gjithashtu se dera e jashtme prej druri si dhe dyert e brendshme janë pothuajse te dëmtuara dhe amortizuara.

Kanalizimi i ujrave të zeza nuk funksionon fare pasi ka qenë dhe është me gropë septike dhe është komplet e bllokuar.

Theksojmë se tek wc-të e shkollës nuk ka ujë të rrjedhshëm për larjen e tyre. Për ujët e pishëm as që bëhet fjalë. Mendohet që në të ardhmen ujë i pijëshem të merret tek një burim i cili është larg në një distance afersisht prej 500 ml.

Theksojmë se në preventivin e hartuar nga ana jonë, është planifikuar që të ndërhyhet në disa procese pune që janë më të domosdoshme dhe emergjente.

Ju bejme medije se nderhyrja do te realizohet vetem ne 6 klasa ku aktualisht janë në funksion për mesim dhe jo në klasat e tjera që nuk kanë nxenës.

Bazuar në preventivin e punimeve është menduar që të ndërhyhet në rikonstrukcionin e një pjese të çatisë prej 132 m², shtrimin e klasave dhe të koridoreve me pllake importi 408 m², vendosjen e dyerve të brendshme në ato klasa që janë në shfrytezim për mesim 14.4 m² si dhe dera e jashtme prej druri me siperfaqe 4 m².

Eshtë menduar që të ndërhyhet në vendosjen e tubacioneve të shkarkimit vertikal të ujrave të çatisë prej 43 ml, të shkarkimit të ujrave të zeza të cilat do të derdhen në një perrua aty afër me një distancë prej 196 ml. të suvatimeve të jashtme prej 38 m² dhe të brendshme në ato vende ku janë të demtuara, si dhe suvatimi i xoklatures prej 42 m²

Eshtë parashikuar që për larjen e wc-vë me ujë të rrjedhshëm, të merret ujë nga një kanal sipër shkollës në një distancë prej 120 ml.

Gjithashtu është menduar që nderhyrja do të bëhet edhe me kanal betoni në pjesën e mbrapme të shkollës që të sistemohen ujrut e shiut dhe të derdhen jashtë shkollës, dhe jo tek trotuari dhe xoklatura prapa shkollës.

Eshtë parashikuar që shkallët e jashtme të cilat janë të dëmtuara të riparohen dhe drejtohen me beton, dhe të vishen me pllaka granili.

Ndërhyrje do të ketë edhe në lysterjen dhe bojatisjen e mureve të brendshme dhe të jashtme të shkollës.

Ju bejmë medije se nderhyrja me punimet e mësipërme si dhe ato që janë parashikuar në preventiv, jo se shkolla do të kthehet e re në gjendjen fillestare, por do të zgjidhë disa probleme të riparimit për disa punime që ishin me emergjente, në menyë që të krijohen kushte më të mira dhe optimale për zhvillimin e procesit mësimor në të ardhmen.

Peshkopi me 14.07.2022

HARTOI:

Ing. Bedri Shehu